



R KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 21.1.2020

Dokument parlamentar

RAPORT PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË MINAMATËS “PËR MËRKURIN””

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e konventës së Minamatës “Për mërkurin””, në mbledhjen e tij të datës 21 janar 2020.

Komisioni caktoi relator për këtë projektligj Zotin Besnik BARAJ.

Të pranishëm gjatë shqyrtimit të projektligjit ishin përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe të Institutit të Shëndetit Publik.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për ratifikimin e konventës së Minamatës “Për mërkurin”” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Projektligji ka si qëllim anëtarësimin në konventën e Minamatës e cila synon mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit nga çlirimet dhe shkarkimet antropogjenike të mërkurit, si dhe kontribuon në kufizimin e kontrollin e shkarkimeve të mërkurit në nivel global. Ai vjen në kuadër të detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare që vendi ynë ka në lidhje me adresimin e problematikave për mërkurin.

Konventa e Minamatës “Për mërkurin” u pa e nevojshme duke qenë se mërkuri është një substancë shumë toksike e cila, nëse shkarkohet në ajër, tokë dhe ujë, mund të shkaktojë rreziqe serioze për njerëzit, peshqit, ekosistemet dhe kafshët e egra, si dhe mund të udhëtojë në distanca të largëta përmes ajrit dhe ujit, duke u bërë kështu një kërcënim global që mund të trajtohet nëpërmjet një bashkëpunimi të mirë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Konventa parashikon adresimin e disa çështjeve duke nisur që nga problemet që shkakton në mjedis dhe në atmosferë lëshimi i pakontrolluar i mbetjeve teknologjike që përmbajnë mërkur; masat për reduktimin e mërkurit në produkte, procese dhe në industritë që përdorin, çlirojnë ose shkarkojnë mërkur; hartimit të legjislacionit dhe ngritjes së kapaciteteve institucionale për mbrojtjen e shëndetit e të mjedisit nga mërkuri dhe përbërjet e tij; etj.

Anëtarësimi në këtë konventë do të jetë i dobishëm pasi i ndihmon palët me anë të përfitimit të fondeve për zbatimin e projekteve të ndryshme në këtë fushë, me fokus mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit në vend nga efektet e dëmshme të mërkurit, si dhe kufizimin e kontrollit të shkarkimeve të mërkurit në nivel global.

Gjithashtu, bërja palë në konventën e Minamatës “Për mërkurin”, do të krijojë përfitime për Shqipërinë në aspektin e ndihmës teknike e financiare, si dhe do t’u mundësojë specialistëve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit e institucioneve të tjera që kanë të bëjnë me adresimin e çështjes së mërkurit, që të trajnohen duke i ndihmuar kështu në hartimin e zbatimit e politikave lidhur me këtë çështje.

Aktualisht, i vetmi problem me mërkurin në Shqipëri konsiston në mbylljen e fabrikës së sodës kaustike (PVC) në Vlorë në vitin 1992, zonë e cila nuk u trajtua në atë kohë për mbetjet e rrezikshme të mërkurit të krijuara gjatë veprimtarisë së fabrikës.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, si dhe me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 2 nene.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis Communautaire***

Ky projektligj nuk përfaqëson ndonjë legjislacion të Bashkimit Europian.

- ***Efektet financiare të projektligjit***

Anëtarësimi në këtë konventë parashikon pagesën vullnetare të një kontributi vjetor. Kontributi vjetor për palët për një vend si Shqipëria vlerësohet në masën 400 deri 800 USD në vit, por nga ratifikimi i kësaj konvente Republika e Shqipërisë pritet të përfitojë më shumë se sa pagesa vjetore modeste si vend anëtar i kësaj konvente.

Gjithashtu, sipas konventës secila palë duhet të sigurojë, brenda mundësive të saj, burimet në lidhje me aktivitetet kombëtare që synojnë zbatimin e konventës, në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar, politikat, prioritetet, planet dhe programet, por përcakton edhe një mekanizëm financiar për të mbështetur palët nga vendet në zhvillim dhe ato me ekonomi në tranzicion në zbatimin e detyrimeve të tyre.

- ***Diskutimi në komision***

Gjatë shqyrtimit të projektligjit relatori i projektligjit u shpreh se është me rëndësi për vendin anëtarësimi në këtë Konventë, pasi mërkuri është një substancë shumë toksike e cila, nëse shkarkohet në ajër, tokë dhe ujë mund të shkaktojë rreziqe serioze për humanët, kafshët dhe mjedisin. Duke qenë një substancë që fle dhe nuk shpërbëhet, është me rëndësi trajtimi serioz i depozitave të mbetura pas mbylljes së Fabrikës së Sodës në Vlorë dhe për këtë një ndihmë dhe orientim do të japë anëtarësimi në këtë Konventë.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, shpjeguan elementët kryesore të kësaj marrëveshjeje, si dhe iu përgjigjën deputetëve në lidhje me Konventën dhe çështjet që lidhen me mërkurin. Ata sqaruan se ka pasur një vlerësim fillestar për Komventën e Minamatës.

Konkretisht, me mbështetjen financiare të Fondit Global për Mjedisin, gjatë periudhës 2016 - janar 2019, në bashkëpunim me UNDP-në, kanë realizuar projektin “Vlerësimi fillestar i Minamatës”, i cili synonte përshpejtimin e përgatitjeve të Shqipërisë për ratifikimin e konventës së Minamatës dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin prej saj. Në këtë projekt përfshiheshin disa aktivitete, takime në të cilat kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve kryesore të linjës, përgjegjëse për adresimin e çështjes së Mërkurit në vend. Një përfitim i qenësishëm i këtij projekti është edhe ekspertiza teknike, e brendshme dhe e huaj, e ofruar në këto takime, që ka kontribuar në ngritjen e kapaciteteve teknike të administratës shtetërore në drejtim të çështjes së mërkurit.

Gjithashtu, ata theksuan përfitimet që do të ketë vendi nga anëtarësimi në këtë Konventë sidomos për sa i përket ekspertizës dhe projekteve për të trajtuar hot – spot-e si ai Vlorës.

Diskutimet në Komision, u përqëndruan kryesisht në:

- problemet me mërkurin pas mbylljes së fabrikës së sodës kaustike (PVC) në Vlorë në vitin 1992, mbetjet e rrezikshme të mërkurit të krijuara gjatë veprimtarisë së fabrikës, dhe projektet e mundshme për trajtimin dhe eliminimin e këtyre mbetjeve të mërkurit;
- mundësia për ekzistencën e të tjera rreziqeve nga mërkuri në vend;
- praktika e deritanishme e trajtimit të këtij hot spot-i në lidhje me mërkurin dhe studimet e kryera për të;
- përfitimet që priten nga anëtarësimi në këtë Konventë; etj.

- ***Përfundim***

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vlerësoi projektligjin për krijimin e mundësive dhe përfitimeve që i vijnë vendit nga anëtarësimi në këtë Konventë për sa i përket trajtimit të çështjeve shqetësuese të ndikimit të mërkurit tek njerëzit, kafshët dhe mjedisi.

Komisioni e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

Besnik BARAJ

Niko PELESHI

Relator

Kryetar